



---

**VENDIM**  
**Nr.55 Date 25.08.2010**  
**PËR**  
**SHTYRJEN E AFATIT PËR REALIZIMIN E KUSHTEVE TE**  
**VENDOSURA NGA ERE SHOQËRISË E-VENTO S.R.L ALBANIA**  
**SH.P.K**

Në mbështetje të neneve 9, 13 pika 1, gërma “a”, dhe 15 të Ligjit Nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 121 dhe 128 të Ligjit nr.8485, datë 12.05.2008 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 25.08.2010, mbasi shqyrtoi informacionin e Drejtorisë së Licensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE shoqërisë E-Vento S.r.l Albania sh.p.k,

**Dhe duke konsideruar :**

Kompleksitetin e problematikes që i licensuari ka hasur për kryerjen dhe dorëzimin e studimit të fizibilitetit të bazuar në matje reale dhe duke qënë se ndërtimi dhe instalimi i parqeve eolik përveç vonesave administrative në të cilat ka kaluar, ka pësuar edhe dëmtime gjatë këtij viti,

**Vendosi:**

1. Të shtyjë me 24 muaj afatet e përcaktuara në vendimin nr. 63, datë 22.09.2009 “Për shtyrjen e afatit për realizimin e kushteve te vendosura nga ERE shoqërisë E-VENTO s.r.l Albania sh.p.k.
2. Drejtorja e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë për Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

**KRYETARI I ERE-s**  
**Bujar NEPRAVISHTA**